

Komuna e Prizrenit 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

Prizreni udhëhiqet nga Ramadan Muja i cili përfaqëson Partinë Demokratike të Kosovës. Ky është mandati i tij i tretë. Mandatin e parë e ka nisur në vitin 2007, atë të dytin më 2009 dhe mandatin e tretë më 2013.

Në zgjedhjet e fundit për kryetar të komunës (nëntor 2013), Muja ka fituar në balotazh ndaj Eqrem Kryeziut nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Ky i fundit në raundin e parë ka siguruar 16,888 vota (apo 25%) ndërsa Muja ka pasur 24,791 vota (apo 37%). Në balotazh Muja ka siguruar 53% të votave.¹

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetar kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.² Mbi 92% e qytetarëve të Prizrenit besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga probleme me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.³ Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Prizrenit me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rënie të theksuar të kënaqshmërisë nga 13.72 pikë në viti 2012 në -18.45 në viti 2015.⁴

Në prag të zgjedhjeve komunale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Prizrenit. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: ndërtimet në zonën

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 20 qershor 2017)

² Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

⁴ Ibid. faqe 39

historike, mungesa e parkingjeve për vetura, prezenca e madhe e lëmshë kërkueseve, prezenca e vazhdueshme e mbeturinave në zonën e quajtur 'nën kala', si dhe derdhja e kanalizimeve në lumin Lumbardh.⁵ Përpos kësaj të fundit, këtë vit qytetarët e Prizrenit kanë identifikuar si problematike edhe bllokimin e trotuareve, qasjen në lëvizje të personave me aftësi të kufizuara, shkatërrimin e qendrës historike, mungesën e korsive për biçikleta si dhe mungesën e hapësirave të gjelbëruara.

Problemet aktuale në Komunën e Prizrenit

Bllokimi i trotuareve

Shkalla e lartë e bllokimit të trotuareve dhe sipërfaqeve të tjera publike është cekur nga qytetarët si fenomen i kudogjendur në Prizren. Trotuaret në rrugët e qytetit të Prizrenit janë sipërfaqe në pronësi publike dhe se çfarëdo veprimi i bllokimit të tyre nga qytetarë apo pronarë lokalesh të papërgjegjshëm është shkelje ligji dhe pengim dhe vështirësim i rrjedhës normale të lëvizjes në qytet në përgjithësi. Komuna e Prizrenit, ka ndërmarrë pak veprime për adresimin e këtij problemi.⁶

Problemet e qarkullimit për personat me nevoja të veçanta

Barrierat e shumta arkitektonike në qytetin e Prizrenit që pamundësojnë lëvizjen e komunitetit të personave me nevoja të veçanta, paraqesin një nga problemet që radhiten si më kritiket nga qytetarët e anketuar. Disa nga problemet kryesore që paraqiten në qytet dhe në ndërtesa e që pengojnë lëvizjen e lirë të personave me nevoja të veçanta janë mungesat e rampave, ose rampa me pjerrtësi të papërshtatshme në institucione publike; mungesa e tualeteve për PAK në këto institucione; mungesa e tualeteve publike për PAK; mungesa e transportit publik të qasshëm; barrierat e ndryshme në infrastrukturë, trotuare dhe hapësirë publike në përgjithësi (bllokimi i trotuareve nga makinat, nga mallra të ndryshme), mungesa e pjerrinave në trotuare, mungesa e fushave taktore për të verbrit, etj. Barrierat arkitektonike që u përmendën lartë nuk pengojnë vetëm lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, por edhe të moshuarve, prindërve me

⁵ Instituti GAP, Komuna e Prizrenit: Problemet kryesore dhe trendët buxhetore. Shtator 2013. Burimi: <http://bit.ly/2oa4nvy>

⁶ Identifikimi i problemeve kryesore të Komunës së Prizrenit është bërë në bashkëpunim me organizatën Ec Ma Ndryshe.

fëmijë, apo edhe secilin njeri në një moment apo situatë të caktuar të jetës.

Shkatërrimi i qendrës historike

Ndër problemet madhore radhiten edhe ndërtimet pa leje, të cilat janë evidente në qendrën historike të Prizrenit, dhe të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shqetësimeve rreth shkatërrimit të qendrës historike. Këto shqetësime këtë vit janë më aktuale se më parë për shkak të një numri të madh të rrënimave të shtëpive përbrenda zonës së ngushtë historike. Këto shqetësime i ka shtuar edhe më shumë edhe rasti tragjik i vajzës tre vjeçare që pati vdekur nga rrëzimi i një pjese të një shtëpie gjysmë të rrënuar në qendrën historike. Prizreni, edhe pse, ndryshe prej qyteteve të tjera, ka plan të konservimit për qendrën historike, por edhe ligj për këtë zonë të veçantë, do të duhej të siguronte dhe të përcaktonte rregullat për ndërtim, zhvillim, por para së gjithash mbrojtje në këtë zonë.

Mungesa e korsive për biçikleta

Mungesa e shtigjeve të biçikletave nëpër rrugët e qytetit të Prizrenit shfaqet si problematike. Prizreni ka traditë të lëvizjes me biçikletë, falë topografisë së përshtatshme. Tendenca e lëvizjes me biçikletë duket se përherë e më shumë po rritet, përkundër pengesave të mëdha që paraqiten në qytet, sikurse trafiku i dendur, por edhe infrastruktura jo e përshtatshme.

Mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet

Mungesa e zonave të gjelbëruara del si shqetësim madhor i qytetarëve. Në qytetin e Prizrenit ka tërësi të mëdha gjelbërimi, sikurse Marashi dhe Parku i qytetit, por për shumë qytetarë këto tërësi të gjelbra mund të jenë larg vendeve që i banojnë. Andaj, nevojitet më shumë sipërfaqeve të gjelbëruara në tërë qytetin, të cilat mund të shërbejnë edhe si hapësira për rekreacion.

Derdhja e kanalizimeve në lumin “Lumbardh”

Derdhja e kanalizimeve në lumin “Lumbardh”. Ky problem që daton nga mandati i kaluar, akoma nuk ka arrit që të zgjidhet. Qyteti i Prizrenit dhe shumë fshatra të tij, kanalizimet i derdhen në lumin që përshkon qytetin. Kjo shkakton kontaminimin e ujit rrjedhës si dhe ndot ambientin. Kanalizimet me ujëra të zeza vërehen të derdhen në lumë edhe në qendër të qytetit, përskaftë urës së gurit.

Fushave që komuna duhet t’u kushtojë vëmendje

Mungesa e parkingjeve

Komuna e Prizrenit krahas komunave tjera të mëdha të vendit akoma nuk ka arritur ta zbusë gjendjen e keqe nga mungesa e parkingjeve për automjete. Kjo mangësi e bën qytetin të jetë i vërshuar nga numri i automjeteve të parkuara në shumicën e rasteve nëpër trotuare. Komuna duhet të shoh këtë problem si prioritet për ta zgjidhur në katër vitet e ardhshme.

Heqja e taksës komunale ndaj bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë në objektet e vjetra

Komuna me qëllim të ruajtjes së objekteve të vjetra në qytet duhet të shoh mundësinë e stimulimit të pronareve të këtyre objekteve. Pjesa dërrmuese e këtyre objekteve në qendër të Prizrenit kanë të hapura lokale të ndryshme në to. Komuna duhet të shqyrtojë heqjen e taksës ndaj tyre duke përfshirë edhe tatimin në pronë me qëllim të inkurajojë qytetaret për mbajtur dhe ruajtur objektet e vjetra. Kjo duhet të fillojë si nismë për t'u shndërruar në një program gjithëpërfshirës institucional me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë.

Trendet buxhetore në Komunën e Prizrenit (2017)


Buxheti total i planifikuar për Komunën e Prizrenit në vitin 2017 është rreth 38.7 milionë euro.⁷ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe rreth 1.6 milionë euro tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara,⁸ ndërsa në vitin 2013 janë bartur rreth 500 mijë euro më pak se këtë vit.⁹ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013, Komuna e Prizrenit ka pasur një rritje të konsiderueshme të buxhetit prej afro 5 milionë euro.

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Prizrenit 2017

⁷ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2tsvCW3>


⁸ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63

⁹ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2wKArJf>, faqe 60



Në bazë të grafikonit të mëposhtëm, shohim se Komuna e Prizrenit vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe mëditje dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme të vogla ku në 2016 është shënuar rënie dhe pastaj rritje sërish në 2017.

Figura nr.2: Trendët buxhetore në komunën e Prizrenit 2013 dhe 2017




Kategoria e pagave dhe mëditjeve është rritur nga afro 15 milionë euro në 2013 në afro 18 milionë euro në 2017. Kjo rritje mund të jetë si rezultat i vendimit të kryeministrit në

vitin 2014¹⁰ për të rritur pagat për 25% në sektorin publik. Me gjithë rritjen në këtë kategori, për komunën e Prizrenit në vitin 2017 ishte planifikuar reduktimi në personel për 123 punëtorë.

Në kategorinë e investimeve kapitale të planifikuara, Prizreni ka pasur rritje afro 700 mijë euro, por pjesëmarrja në buxhetin total për vitin 2017 ishte zvogëluar për tre pikë përqindjeje nga 42% në 2013 në 39% në vitin 2017. Kategoria e shpenzimeve komunale dhe e mallrave dhe shërbimeve është rritur, por pjesëmarrja në buxhet mbetet me përqindje të njëjtë. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve është zvogëluar për afro 58 mijë euro dhe pjesëmarrja në buxhetin total të komunës është 1%, ndërkaq para katër vitesh ishte 2%.

Figura nr.3: Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017




Komuna e Prizrenit radhitet e dyta në nivel vendi në lidhje me realizimin e të hyrave vetanake. Kështu në vitin 2016 Komuna e Prizrenit ka pasur të hyra në vlerë prej 6.3 milionë euro, apo afro 2.3 milionë euro me shumë sesa gjatë vitit 2013. Rritja e të hyrave vlerësohet të ketë ardhur kryesisht nga rritja e numrit të bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë

¹⁰ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M>

komunë, por ndikim pozitiv konsiderohet të ketë pasur edhe procesi i faljes së borxheve, proces ky që është kushtëzuar ndaj qytetarëve me shlyerjen e borxheve të caktuara.

Figura nr.4: Të hyrat vetanake në Komunën e Prizrenit 2013-2016



Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës të dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerret këto veprime:

- Komuna duhet të marrë masa për të siguruar se Qendra Historike e Prizrenit të mos shkatërrohet edhe më tutje.
- Komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e heqjes së taksave ndaj bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë në objektet e vjetra, me qëllim të inkurajimit të pronarëve për t'i ruajtur këto objekte.
- Komuna duhet të vendosë pengesa të caktuara në trotuar me qëllim që kjo hapësirë të shfrytëzohet nga këmbësoret dhe jo nga automjetet.
- Komuna duhet t'i shtojë hapësirat e gjelbëruara në qytet.
- Komuna duhet të sigurojë fonde për të zgjidhur problemin e ujerave të zeza në qytet, veçmas derdhjen e tyre në lumin e qytetit.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world